

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Nr. prot.23320

Datë: 09.10.2017

AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Nr. prot.1013

Datë: 10.10.2017

BANKA EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nr. prot.01

Datë: 09/10/2017

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NDËRMJET

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

DHE

AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA

DHE

BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

NË LIDHJE ME

**KRIJIMIN E NJË PLATFORME INFORMIMI
PËR TATIMPAGUESIT NË SHQIPËRI**

MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT (më tej i quajtur këtu “**Memorandumi**”) ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në Republikën e Shqipërisë (më tej e quajtur këtu “**DPT**”), Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara në Republikën e Shqipërisë (më tej e quajtur këtu “**ADISA**”), dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (më tej e quajtur këtu “**Banka**” apo “**BERZH**”), (më tej veçmas të quajtura këtu “**Palë**” dhe bashkarisht të quajtura “**Palët**”).

DUKE QENË SE Banka është organizatë ndërkombëtare e themeluar nën ligjin publik ndërkombëtar në bazë të Marrëveshjes që Themelon Bankën datuar më 29 maj 1990 (“**Marrëveshja**”), Republika e Shqipërisë është bashkëngjitur në Marrëveshje dhe është bërë anëtare e Bankës më 18 dhjetor 1991;

DUKE QENË SE Administrata Tatimore në Republikën e Shqipërisë ka detyrën të mbledhë të ardhurat tatimore përmes procedurave të thjeshta dhe me kosto minimale, duke zbatuar njëtrajtësisht legjislacionin tatimor, për financimin e buxhetit të shtetit shqiptar, dhe në këtë kontekst, DPT ofron asistencë dhe shërbime që të rrisë ndërgjegjësimin për pagimin e tatimeve dhe taksave, në mënyrë që tatimpaguesit të përmbushin detyrimet e tyre tatimore sipas legjislacionit në fuqi;

DUKE QENË SE ADISA është një institucion publik, i mandatuar të ofrojë shërbime në sportele të integruara për qytetarët; të krijojë dhe menaxhojë qendrat që ofrojnë shërbime publike të integruara me një ndalesë (*one-stop-shop*); të marrë pjesë në hartimin e procedurave dhe standardeve për sportelet pritëse të qytetarëve (*front office*) dhe zyrave mbështetëse (*back office*) lidhur me ofrimin e shërbimeve; dhe të monitorojë cilësinë e transparencën e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarit në sportele;

DUKE QENË SE Palët dëshirojnë të bashkëpunojnë për të asistuar, informuar dhe rritur ndërgjegjësimin ndërmjet bizneseve, veçanërisht ndërmarrjeve mikro, të vogla e të mesme për zbatueshmërinë e kërkesave të kuadrit legjislativ që rregullon tatimet, doganat dhe/ose licensimin dhe lejet (“**Objektivi**”);

PËR KËTË ARSYE, Palët kanë arritur mirëkuptimin si vijon, që të lehtësojnë bashkëpunimin, në baza jo ekskluzive, për realizimin e Objektivit:

Seksioni 1

Qëllimi

Qëllimi i përgjithshëm i Palëve është të përmirësojnë mbledhjen e tatimeve duke ofruar informacionin e nevojshëm, të aksesueshëm dhe të përditësuar, lidhur me kërkesat tatimore përkundrejt bizneseve, veçanërisht përkundrejt ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Për të arritur qëllimin e mësipërm, Palët dëshirojnë të bashkëpunojnë në krijimin e një *helpdesk-u* dhe platforme që të ofrojë informacion parësor, si për bizneset ekzistuese ashtu edhe për ato që regjistrohen rishtas, mbi hapat që duhen ndjekur për të plotësuar kërkesat tatimore. Informacioni dhe udhëzimet që synohet të ofrohen do të mbulojnë tatimet qendrore e lokale, detyrimet doganore, si dhe kërkesat për lejet e licensat (aty ku është relevante). Ky informacion do të jetë i përshtatur për secilën prej kategorive të identifikuar të bizneseve sipas legjislacionit në fuqi, dhe do të ofrohet në formate të lehta për t’u përdorur, përfshirë materiale të printuara dhe media audio-vizive.

Seksioni 2

DPT

DPT, brenda kopetencave të saj dhe në përputhje me legjislacionin në Shqipëri, synon të:

- (a) Sigurojë informacionin dhe asistencën që mund të kërkohej nga konsulentët që synohen të punësohen nga BERZH për përgatitjen dhe përshtatjen e informacionit për tatimpaguesit, siç shpjegohet në Seksionin 4 (b) më poshtë.
- (b) Sigurojë korrektësinë e paketave informative të hartuara nga konsulentët e ngarkuar nga BERZH, sipas Seksionit 4 (b) më poshtë.
- (c) Informojë për përfitësimet e nevojshme çdo herë që do të ketë amendime apo ndryshime të legjislacionit fiskal përgjatë kohës që ky Memorandum do të jetë në fuqi, në mënyrë që këto amendime të pasqyrohen në materialet informuese.
- (d) Aty ku është e mundur, të ofrojë akses në kanalet e veta të komunikimit me tatimpaguesit (si faqja e internetit, zyrat e informacionit, etj.) në mënyrë që materialet informuese të përfshihen dhe publikohen në këto kanale.
- (e) Sigurojë informacion dhe asistencë për lehtësimin e çdo aktiviteti tjetër që Palët mund të vendosin të organizojnë së bashku për realizimin e Objektivit përgjatë kohës që ky Memorandum do të jetë në fuqi.

Seksioni 3

ADISA

ADISA, brenda kopetencave të saj dhe në përputhje me legjislacionin në Shqipëri, synon të:

- (a) Të mbështesë krijimin e *helpdesk*-ut të tatimpaguesve në qendrat e saj që ofrojnë shërbime publike të integruara me një ndalesë (*one-stop-shop*) në Krujë dhe në Fier, duke siguruar akses në ambiente, hapësirë fizike, dhe mbështetje organizative. Çdo detyrim financiar për krijimin e *helpdesk*-ut të tatimpaguesve synohet të jenë subjekt i një marrëveshjeje të veçantë.
- (b) Të sigurojë dy anëtarë të stafit të saj për shpërndarjen e informacionit tek tatimpaguesit, apo referimin e tatimpaguesve tek sportelet e dedikuara brenda qendrës së integruar të shërbimeve ku ky informacion shpërndahet, përgjatë kohës që ky Memorandum do të jetë në fuqi. Çdo detyrim financiar për këta dy anëtarë të stafit synohet të jenë subjekt i një marrëveshjeje të veçantë.

Seksioni 4

BERZH

BERZH synon të sigurojë asistencë teknike për realizimin e Objektivit, në përputhje me sa më poshtë:

- (a) Angazhimin e konsulentëve që do të ndërmarrin vrojtime për vlerësimin e

bizneseve, veçanërisht ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, në rajonet e targetuara për të ndërhyrë, për të kuptuar më mirë nevojat e tyre për informacion mbi përputhshmërinë me detyrimet tatimore. Vrojtimit mendohet të zhvillohen si përpara ashtu edhe pas ofrimit të informacionit dhe *helpdesk*-ut, për të vlerësuar efektivitetin e informacionit të dhënë dhe formave të shpërndarjes së tij.

- (b) Angazhimin e konsulentëve që do të përgatisin materialet e përshtatura me informacion mbi kërkesat për detyrimet tatimore, si dhe do t'i përditësojnë ato me korrektësi dhe në kohën e duhur për sa kohë ky Memorandum do të jetë në fuqi.
- (c) Angazhimin e konsulentëve që do të dizenojnë dhe përgatisin formatet e nevojshme për shpërndarjen e informacionit tek tatimpaguesit.
- (d) Asistencë dhe mbështetje për shpërndarjen e informacionit nëpërmjet DPT dhe/ose sporteleve të dedikuara për dhënien e informacionit përkundrejt tatimpaguesve, brenda qendrave të integruara të ofrimit të shërbimeve publike të ADISA-s.
- (e) Bashkëpunimin e ngushtë me DPT për të përmirësuar dhënien e informacionit përkundrejt tatimpaguesve nëpërmjet kanaleve të komunikimit ekzistuese e atyre potenciale, përgjatë kohës që ky Memorandum do të jetë në fuqi.

Seksioni 5 Komunikimi

Çdo njoftim apo komunikim tjetër që do të jepet apo bëhet sipas këtij Memorandumi do të adresohet dhe do të dërgohet në pikat e mëposhtme të kontaktit apo në një adresë tjetër që secila Palë e përcakton përmes lajmërimit me shkrim drejtuar Palës tjetër:

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve:

Adresa: Rruga Gjën Bue Shpata, Tiranë, Shqipëri
Drejtuar: Z. Artur Papajani, Drejtor, Shërbimi i Tatimpaguesve
Zj. Ira Dinga, Këshilltar i Drejtorit të Përgjithshëm
Fax: + 355 422 76 805.
Email: Artur.papajani@tatime.gov.al
Ira.dinga@tatime.gov.al

Për ADISA:

Adresa: Blv. "Zhan d'Ark", ish Hoteli Oficerave, kati i 6-të, Tiranë, Shqipëri
Drejtuar: Z. Erkand Kola, Drejtor, Drejtoria për Zhvillimin dhe Monitorimin e Standardeve
Fax: N/A
Email: erkand.kola@adisa.gov.al

Për Bankën:

Adresa: Rr. Abdi Toptani Street, Torre Drin, Kati 4, Tiranë, Shqipëri
Drejtuar: Zj. Endrita Xhaferaj, Eksperte për Klimën e Investimeve
Fax: +355 (4) 2230 580
Email: xhaferae@ebrd.com

Seksioni 6

Dispozitat Përmbyllëse

- (a) Ky Memorandum reflekton pikëpamjet dhe qëllimet e Palëve për të bashkëpunuar në bazë jo ekskluzive, shprehur në mirëbesim por pa krijuar ndonjë detyrim ligjor ose financiar apo ndonjë detyrim tjetër për secilën prej palëve. As nuk do të ketë përfitime ligjore për ndonjë palë të tretë nga ky Memorandum.
- (b) Është kuptuar dhe rënë dakord që asgjë në këtë Memorandum nuk do të përbëjë, apo interpretohet si, një ofertë, premtim apo sipërmarrje nga asnjëra prej Palëve për të financuar ndonjë pjesë apo aktivitet të identifikuar në këtë Memorandum apo në vijim të tij.
- (c) Në rast se do të identifikohen mundësi të tjera, përgjatë ose si rezultat i bashkëpunimit ndërmjet Palëve, marrëveshje specifike për këto aktivitete apo projekte do të duhet të pranohen nga Palët. Secila prej palëve do të marrë përsipër shpenzimet përkatëse që mund të burojnë si rrjedhim i zbatimit të këtij Memorandumi, përveç për sa specifikuar në marrëveshjet e veçanta.
- (d) Asgjë në këtë Memorandum nuk do të kufizojë të drejtën, apo të ndalojë Palët nga hyrja në memorandume apo marrëveshje me palë të tjera lidhur me çfarëdo aktiviteti, projekti apo fushe bashkëpunimi të mbuluar nga ky Memorandum.
- (e) Palët do të takohen në mënyrë periodike por jo më pak se një herë në 3 (tre) muaj, për të diskutuar zbatimin e këtij Memorandumi, vlerësuar arritjet e objektivave të vendosura këtu më sipër dhe për të shqyrtuar rregullime të nevojshme, nëse ka.
- (f) Asgjë në këtë Memorandum nuk do të përbëjë apo nuk do të interpretohet si akt i heqjes dorë, mospranimi apo i ndonjë lloji modifikimi, as të shprehur e as të nënkuptuar, të ndonjë prej privilegjeve, imuniteteve dhe përjashtimeve të dhëna ndaj BERZH në Marrëveshjen që Themelon BERZH-in, sipas konventave ndërkombëtare, apo të ndonjë ligji në zbatim.
- (g) Çfarëdo mosmarrëveshje që del nga, apo në lidhje me, interpretimin apo aplikimin e ndonjë dispozite të këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të zgjidhet miqësisht përmes konsultimeve dhe diskutimeve ndërmjet Palëve.
- (h) Ky Memorandum do të hyjë në fuqi në datën kur të nënshkruhet nga Pala e fundit prej të tre Palëve dhe do të mbetet në fuqi deri në 31 Dhjetor 2019.
- (i) Ky memorandum mund të ndryshohet me konsensus të përbashkët me shkrim nga Palët.

NË DËSHMI, DPT, ADISA dhe Banka, secila duke vepruar përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Memorandum Mirëkuptimi në tre kopje origjinale në secilën gjuhë, Shqip dhe Anglisht. Në rast të mospërputhjeve midis dokumenteve në Shqip dhe Anglisht, prevalencë do të ketë dokumenti në gjuhën Angleze.

**PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TATIMEVE NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË**

Nga: _____
Emri: Vasilika Vjera
Titulli: Drejtor i Përgjithshëm i DPT

**PËR AGJENCINË E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË
INTEGRUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË:**

Nga: _____
Emri: Anisa Çika
Titulli: Drejtor Ekzekutiv i ADISA

PËR BANKËN EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM:

Nga: _____
Emri: Matteo Colangeli
Titulli: Drejtor i zyrës së BERZH në Shqipëri

TIRANA
Resident Office